

KUR DIKUSH TJETËR HESHT, **TI FOL!**

Veprimi yt mund të shpëtojë jetën e dikujt. Edhe reagimi më i vogël është një hap i madh për një grua që jeton me frikë.

MOS JI DËSHMITAR I HESHTUR!

Dhuna psikologjike dhe fizike lënë pasojë të thella dhe të padukshme.

Telefona në **192, 112**

ose në **Qendrën më të afërt për punë sociale**



Ky produkt është përgatitur si pjesë e projektit "Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore në Maqedoninë e Veriut" të financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë përmbajtje jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet dhe pikëpamjet e Qeverisë Britanike.

MOS JI DËSHMITAR I HESHTUR!

Raporto menjëherë dhunën ndaj grave!



PO SIKUR DIÇKA E TMERRSHME TË NDODHË PAS DERËS?

Një debat i fortë dëgjohej në ndërtesë. Pothuajse të gjithë fqinjët mbyllin sytë dhe zemrat. Por dikush ndalon. Dëgjon. Merr vendimin e duhur dhe ndryshon gjërat - **raporton**.

Çdo ditë, shumë gra dhe vajza përballen me dhunë në shtëpi, atje ku duhet të ndjehen më të sigurta.

Mos hesht. Mos e kthe kokën. Mos e injoro problemin.

MOS JI DËSHMITAR I HESHTUR!

*Dhuna psikologjike lë pasojë të padukshme tek viktimat.
Telefoni në 192, 112 ose në Qendrën më të afërt për punë sociale.*

KA NDIHMË PËR NJË JETË PA DHUNË.



Jeta e përditshme plot dhunë të heshtur

Në heshtjen e ndërtesave tona, midis mureve ku jetojmë, fshihen histori që rrallë tregohen. Dëgjojmë britma, debate, fjalë që lëndojnë. Kalojmë pranë. Nxitojmë të kalojmë pranë. Por secili prej nesh është një dëshmitar i rëndësishëm, me forcë për të ndaluar dhunën.



Si e dalloni dhunën?

- Shpesh dëgjon zënka dhe britma nga i njëjti apartament.
- Shenja të dukshme fizike ose frikë tek ndonjë grua.
- Gruaja kërkon falje, hesht dhe tërhiqet.



Çfarë mund të bësh?

- Ndalo. Dëgjo. Reago.
- Pyet nëse nevojitet ndihmë.
- Nëse je në dilemë, telefono në mënyrë anonime.
- Trego dhembshuri dhe humanizëm, mos e normalizo dhunën.